

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

ROLI I FONDEVE TË PENSIONIT NË TREGUN FINANCIAR DHE RËNDËSIA E
TYRE SI INVESTIM AFATGJATË PËR PËRFITUESIT

Razie Selimi¹

Abstrakt

Një fond pensioni është një financim, i cili siguron të ardhura për periudhën pas daljes në pension. Ai mund të jetë privat ose publik, ku dallimet mes të cilave janë të qarta në ligj dhe rregullore si dhe në kërkesat që përmbajnë. 300 fondet e pensioneve më të mëdha në botë përmbajnë rreth 6 trilion dollarë në asete, pra një normë të konsiderueshme në ofertën monetare të vendeve përkatëse. Pra, edhe pse në tregun financiar të tyre ai ka ndikim të dukshëm, në Shqipëri fondi i pensioneve private ka ende problematika. Përse është kjo dhe si mund ta forcojmë ne rolin e tij si një investim afatgjatë?

Për shumicën e popullsisë skema shtetërore e pensionit nuk është e mjaftueshme, kështu që ky boshllëk plotësohet me anë të fondit privat, që vjen në formën e pagesave të menjëhershme dhe si një investim i rëndësishëm për të plotësuar nevoja shtesë.

Kontributi për pension është i zbritshëm për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat dhe interesi i përfituar përjashtohet në tatim. Anëtarët e fondit përfitojnë gjithashtu edhe nga fakti që fondi mbledh shumë anëtarë dhe përfiton nga ekonomia e shkallës, duke ulur kostot për njësi. Ky është një ndikim direkt i fondit të pensioneve në tregun financiar.

Problematikat kryesore lidhen më së shumti me ekonominë e dobët të vendit tonë, mungesa e njohurive të qytetarëve mbi fondet private të pensioneve si dhe mosbesimi ndaj tyre. Duke parë peshën që fondi i pensioneve ka në përfitimin personal të individëve si dhe në tregun financiar, duhet që problematikat të kapen në themelet e tyre dhe të asgjësohen.

Më e rëndësishmja dhe ajo e cila ne kemi më shumë në dorë, është opinion publik mbi këto fonde. Duhet fituar besimi i tyre dhe provuar që nuk është një tjetër skemë, por një investim me vlerë për veten e tyre, rezultatet e të cilit i shohim në një periudhë afatgjatë, si dhe duke i njohur ata me rëndësinë e fondit në ekonomi.

Fjalët kyçe: *fond pensioni, treg financiar, besueshmëri, investim afatgjatë.*

¹ Viti I - Menaxhim Biznesi, Albanian University: raziselimi@hotmail.com